



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislacioni -III**

Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës së Kuvendit  
Mbledhja nr. 01-2008  
Prishtinë, me 25 shkurt 2008, ora 11:10  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 203

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës së Kuvendit

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Kolë Berisha, Džezair Murati, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Fehmi Mujota, Ramadan Gashi, Fatmire Berisha, Suzana Novobërdaliu.

Munguan: Ismet Beqiri, Besa Gaxherri.

Pjesëmarrësit nga monitorimi:  
Reshit Gashi-NDI.

Nga zyra e komisioneve të Kuvendit: Idriz Tahiri, Drita Çarkaxhiu, Behlul Zeka dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

**RENDI I DITËS**

1. Konstituimi i Komisionit
2. Të ndryshme

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**1. Konstituimi i Komisionit**

**Ahmet Isufi** - kryetar i Komisionit tha se ky është takimi i parë konstituiv i Komisionit dhe me këtë rast do të diskutohen vetëm këto dy pika. Ai më tutje i uroj, të gjithë anëtarët për punë të mbarë dhe gjithashtu shtoi se përbërja e këtij komisioni është mjaft e mirë. Ai theksoi se gjatë punës në Komision do të jemi të hapur dhe gjithashtu do të bashkëpunojmë, punohet së bashku me sekretarinë e Komisionit. Pastaj i prezantoi anëtarët e Komisionit. Zëvendëskryetar i parë është Kolë Berisha, ndërsa zëvendëskryetar i dytë është Džezair Murati.

**Džezair Murati** - I përshëndeti anëtarët e Komisionit dhe theksoi se ky komision është themeluar për herë të parë dhe tash do të funksionojë në Republikën e Kosovës. Ai shtoi se në përbërjen e këtij komisioni ka anëtarë me përvojë si: juristë dhe njohës të fushave të ndryshme, u uroi sukses në punë.

Gjithashtu pas prezantimit të tyre Komisionin e përshëndetën edhe anëtarët: **Ramadan Gashi, Fehmi Mujota dhe Fatmire Berisha.**

**Suzana Novobërdaliu** - Përshëndeti anëtarët dhe theksoi se është hera e parë që u zgjodh si deputete dhe u shpreh se bashkërisht do të jemi të suksesshëm.

**Hydajet Hyseni-Kaloshi** - Gjithashtu i përshëndeti anëtarët e Komisionit dhe theksoi se me vullnetin dhe angazhimin e përbashkët të Komisionit do të arrijmë suksese.

## 2. Të ndryshme

**Ahmet Isufi** - Tha se më parë ky komision ka qenë komision ad hoc ndërsa në këtë legjislaturë është themeluar si i rregullt. Ai më tutje kërkoi që të caktohet edhe orari i mbledhjeve. Ai kërkoi të caktohen ditët dhe ora për mbajtjen e mbledhjeve të komisionit dhe pyeti për propozime konkrete në lidhje me këtë.

**Hydajet Hyseni-Kaloshi** - Konsideroi se pasi ky komision është i veçantë, dhe propozoi të hartohet një program i punës së Komisionit, pra të bëhen afatizimet. Ai, gjithashtu, kërkoi që në një nga mbledhjet e ardhshme të prezantohet edhe ndonjë raport i bërë gjatë punës së legjislaturës së kaluar të Kuvendit. Në lidhje me punët në këtë komision, ai theksoi se më tepër punë do të ketë lidhur me Rregulloren e Punës. Gjithashtu me rëndësi është vendosja e marrëdhënieve të punës me organizatat mbështetëse.

**Ahmet Isufi** - theksoi se beson se do të bëhet një punë e suksesshme se duhet siguruar materialet e punës së Komisionit të kaluar dhe gjithashtu të bëhet një takim me ish-kryetarin e këtij komisioni, Hajredin Kuqin.

**Suzana Novobërdali** - Tha se Komisioni i mëparshëm ka qenë për mandate dhe imunitete, sipas informacionit që kam nuk është marrë edhe me çështjen e Rregullores së Punës. Pastaj ajo shtoi se Komisioni duhet të përqendrohet më tepër në çështjen e Rregullores së Punës.

**Hydajet Hyseni-Kaloshi** - Tha se në legjislaturën e kaluar ka qenë një komisioni i veçantë që ka punuar vetëm në Rregullore të Punës dhe pasi e ka kryer punën është shuar.

Ai theksoi se këtu janë dy drejtime të përgjegjësive: 1. çështjet normative dhe 2. mbikëqyrja e zbatimit. Ai më tutje shtoi se edhe pa u miratuar Kushtetuta ne mund të punojmë, duke shikuar Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit.

Kryetari i falënderoi edhe një herë të pranishmit dhe deklaroi mbledhjen të mbyllur.  
Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

*Procesverbalin e hartoi:*  
Behlul Zeka, zyrtar ligjor

**Kryetari i Komisionit**

---

Ahmet Isufi